



# REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO

## AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

AGENCIJA ZA SPRJEÇAVANJE KORUPCIJE

THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, si dhe Rregulloren Nr. 03/2023, për Procedurat e Hetimeve Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 24.06.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

|  |      |           |
|--|------|-----------|
| AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT |      |           |
| AGENCIJA ZA SPRJEÇAVANJE KORUPCIJE       |      |           |
| AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION      |      |           |
| Dep.                                     | DPKI | Nr. Prot. |
| Dep.                                     | 03   | Br. Prot. |
| Dep.                                     |      | Prot. No. |
| Mrs. Faq.                                | 03   | Date      |
| Br. Str.                                 |      | Division  |
| Mrs. Faq.                                |      | D         |

904/24  
24-06-24

I. Mbylljet rasti APK-DPKI-06-206/24, për zyrtarin e lartë z. Burim Shala, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ekoregjioni” Sh.A në Prizren, për shkak se nuk ka prova që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit.

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korruptionit, pas pranimit të një raportimi ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, me pretendimin se;

Burim Shala, duke qenë aksionar dhe përfaqësues i autorizuar në biznesin privat “Koha – B Group” Sh.P.K, ka fituar kontratë prokurimi nga Komuna e Prizrenit me titull “Ofrimi i shërbimeve për projektin Treni si atraksion turistik”.

Ndërkohe gjatë zhvillimit të procedurës është pranuar një kërkesë për shqyrtimin e konfliktit të interesit me pretendimin e përshkruar si më lartë, si dhe pretendimin tjetër se; *i njëjti është i afërt me pushtetin lokal në Prizren dhe është pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) nga i cili subjekti po ashtu vjen edhe Kryetari i Komunës së Prizrenit Shaqir Totaj.*

I. Agjencia në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pas kësaj, zyrtari i lartë është njoftuar për pretendimin e ngritur për konflikt interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas shqyrtimit pretendimeve, dokumentacionit të pranuar, konstaton si në vijim:

Fakti se Burim Shala, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Regionale “Eko Regjioni” Sh.A në Prizren, ka përfituar kontratë prokurimi si bashkë aksionar me operatorin ekonomik “Koha - B. Group” Sh.P.K, nuk është e ndaluar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

Neni 13 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit shprehimisht thuhet;

Papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik

1. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.

2. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.

3. Personat e përmendorur në paragrafët 1. dhe 2. të këtij nenit, si dhe ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar apo i afërm, nuk kanë të drejtë të lidhin kontratë ose të përfitojnë ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë ushtron detyra publike.

4. Nëse zyrtari i lartë bie në kundërshtim me paragrafin 3. të këtij nenit, atëherë Agjencia duhet të kërkojë nga organi kompetent anulimin e kontratës me ndërmarrjen apo kthimin e çfarëdo përfitimi të padrejtë të ndërmarrjes tek institucioni në të cilin zyrtari i lartë ushtron funksion publik.

Referuar kufizimit të përcaktuar në nenin 13 paragrafi 3, në cilësinë e zyrtarit të lartë Burim Shala, Kryeshefit Ekzekutiv e ka të ndaluar të përfitoj kontratë apo ndihmë me institucionin ku e ushtron funksionin e zyrtarit të lartë publik, pra me Ndërmarrjen Publike Rajonale “Eko Regjioni” Sh.A në Prizren.



Në lidhje me pretendimin për lidhje politike, ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, dhe Burim Shala, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Rajonale “Eko Regioni” Sh.A në Prizren, Agjencia ka kërkuar informacione nga Partia Demokratike e Kosovës.


Në përgjigjen e ofruar nga Partia Demokratike e Kosovës, është sqaruar se Burim Shala, nuk ka ushtruar dhe nuk ushtron ndonjë funksion/detyrë në Partinë Demokratike të Kosovës.

II Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij nenit, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtori të DPKI- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

  
Ilir Buleshkai  
Drejtësor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korruptionit

